



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 shkurt 2023
Nr. Ref.:RK 2131/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI51/22

Parashtrues

Naser Mustafa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, ARJ. nr. 102/2021 të 29 dhjetorit
2021, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Mustafa, me vendbanim në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Urim Bajraktari, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ. nr. 102/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 19 janar 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenet 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani me Vendimin GjR. KI51/22, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI51/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 6 maj 2022, Gjykata për regjistrimin e kërkesës njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 8 shkurt 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Kërkesa ka të bëjë me një kontest civil mes parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Ferizajt, përkitazi me kompensimin dhe këmbimin e një paluajtshmërie (lokali afarist) të shpronësuar nga Komuna e Ferizajt për qëllime të zgjerimit të një rruge.

Paluajtshmëria në fjalë në librat kadastral evidentohet me nr. 2484/2, me një sipërfaqe prej 218 m², e regjistruar në emër të parashtruesit të kërkesës, e cila i ishte dhënë në shfrytëzim kompanisë H. C. Jatex Sh A - Gjakovë. Sipas shkresave të lëndës vërehet se kompensimi i paluajtshmërisë ende nuk ka ndodhur, si rezultat i inicimit të kontestit në gjykata.

12. Më 17 prill 2009, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim, e Komunës së Ferizajt, nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, kërkoi fillimin e procedurave për shpronësimin e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës për qëllime të zgjerimit të rrugës "Hamëz Jashari".
13. Më 11 nëntor 2009, Kryetari i Komunës së Ferizajt B. Xh., me Vendimin përfundimtar 03-nr. 465-7, miratoi kërkesat e drejtorive përkatëse.
14. Më 14 janar 2010, Drejtoria për Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, e Komunës së Ferizajt, sipas tekstit të procesverbalit [03-nr. 465-07], nënshkroi një marrëveshje me parashtruesin e kërkesës për mënyrën e kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar. Parashtruesi i kërkesës nga Komuna e Ferizajt kishte kërkuar kompensim monetar për fitimin e humbur nga qiradhënia, për periudhën 1 korrik 2008 - 31 dhjetor 2009. Ndërsa në këmbim të paluajtshmërisë së tij, kërkoi t'i jepej lokali në pronësi të Komunës së Ferizajt, në rrugën "Dëshmorët e Kombit", në këmbim 1 me 2 m², ose tokë ndërtimore në rrugën "Rexhep Bislimi". Sipas procesverbalit të lartcekur palët janë pajtuar që kompensimi përfundimtar të bëhej në raport 2.4 m² e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës, për 1.0 m², të lokalit në pronësi të Komunës së Ferizajt.
15. Më 16 shkurt 2010, kryetari i Komunës së Ferizajt B. Xh., me Vendimin nr. 01/zyrtarisht, anuloi marrëveshjen e 14 janarit 2010, për kompensimin dhe këmbimin e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se nuk është bërë vlerësim real i vlerës së pronave.
16. Më 30 janar 2013, Drejtoria për Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, me njoftimin 03-nr.465-7/09, informoi kryetarin e Komunës së Ferizajt A. A, lidhur me nxjerrjen e Vendimit nr. 01/zyrtarisht të 16 shkurtit 2010, nga ish- kryetari i mëparshëm B. Xh., me të cilin ishte anuluar marrëveshja e 14 janarit 2010.
17. Më 19 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës sipas procedurës për konflikte administrative, parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative të Komunës së Ferizajt, për të dhënë një shpjegim përkitazi me anulimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010.
18. Më 18 maj 2015, Kryetari i komunës së Ferizajt M. S., me Vendimin 01. nr. 104/2015, lejoi zbatimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, duke urdhëruar drejtorinë përkatëse komunale që të bëjë ndryshimet e nevojshme në librat kadastral.
19. Më 3 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës, pas bisedave të shumta me Kryetarin e komunës së Ferizajt M. S., e tërhoqi padinë e ushtruar, kundër komunës së Ferizajt, me të cilën kishte kërkuar zbatimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010.
20. Më 26 qershor 2015, Kryetari i Komunës së Ferizajt, M. S., me Vendimin 01. nr. 159/15, shfuqizoi Vendimin e mëparshëm 01. nr. 104/2015, të 18 majit 2015 për zbatimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, duke u thirrur në Vendimin nr. 1/zyrtarisht të 16 shkurtit 2010, të ish- Kryetarit B. Xh.

21. Më 8 korrik 2015, Komuna e Ferizajt, me Vendimin nr. 60052/2015, obligoi drejtorinë përkatëse komunale, që të kthej në gjendjen e mëparshme evidencën mbi pronësinë e pronës, në librat kadastral.
22. Më 27 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi një padi të dytë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nëpërmjet së cilës kërkoi anulimin e Vendimit [01. nr. 159/15], të 26 qershorit 2015 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, dhe zbatimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010.
23. Më 16 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin A. nr. 1380/15 e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin: *“Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve kontestuese konform nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) - Ligji nr. 03/L-202, gjykata në bazë të provave të administruara dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar”*.
24. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të 16 majit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimin për shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 15 qershor 2021, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin AA. nr. 558/2019, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktgjykimin e 16 majit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me arsyetimin se vendimi i shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, i aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.
26. Më 11 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje të nenit 6 dhe nenit 2.1 të Protokollit nr. 7 të KEDNj-së, shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 29 dhjetor 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin ARJ. nr. 102/2021, me të cilin refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin: *“...Gjykata Supreme, konstaton se në këtë çështje administrative juridike gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale, kështu që pretendimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara dhe jo me ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër nga ajo e vërtetuar nga gjykatat e instancave më të ulëta”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ai i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së.
 - i. Pretendimi për shkelje të së drejtës për *“gjykim të drejtë”*

29. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore, më pas ajo e Apelit dhe Supreme, (i) duke mos i konsideruar si të kundërligjshme vendimet e kryetarëve të Komunës së Ferizajt, (ii) duke mos marrë parasysh faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me moszbatim të marrëveshjes për kompensim dhe këmbim të paluajtshmërive, të nënshkruar mes tij dhe autoriteteve të komunës, dhe (iii) duke i vlerësuar si të ligjshme vendimet për anulimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, me arsyetimin se nuk u përfillën procedurat e shpronësimit sipas Ligjit për Shpronësimin e Paluajtshmërive, kanë shkelur të drejtat e tij për një gjykim të drejtë.
30. Në këtë drejtim parashtruesi i kërkesës thekson se nga gjykatat është kërkuar që të vlerësonin nëse Vendimi nr. 01/zyrtarisht i 16 shkurtit 2010 i Kryetarit të komunës B. Xh., për anulimin e marrëveshja së 14 janarit 2010, dhe Vendimi 01 nr. 159/15 i 26 qershorit 2015, i Kryetarit të komunës M. S., për shfuqizimin e vendimit të mëparshëm 01. nr. 104/2015, të 18 majit 2015, ishin në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.
- a) Pretendimi për shkeljen e së drejtës për “qasje në gjykatë”
31. Në lidhje me të drejtën për qasje në drejtësi, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Duke mos administruar provat në mënyrë të drejtë Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në tërësi vetëm ka përshkruar në stilin copy paste Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe në asnjë paragraf nuk i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Madje, Gjykata Supreme vjen në përfundim, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës duhet që të drejtën e tij ta realizoj në procedurë tjetër të kompensimit sipas Ligjit mbi Shpronësimin, duke mos i trajtuar fare pretendimet e paditësit. Prandaj parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbrojtje ligjore për mënyrën se si i janë nxjerrë vendimet nga ana e Komunës së Ferizajt, duke i mohuar në mënyrë të vazhdueshme për rreth 13 vite që parashtruesi i kërkesës të mund që ta posedoj dhe shfrytëzoj pronën e tij e cila i është marrë nga ana e Komunës, në emër të eksproprijimit e duke iu dhënë një pronë tjetër sipas Bashkëujdisë - Marrëveshjes, me të paditurin por që sipas gjendjes faktike kjo pronë nuk iu është dorëzuar në posedim asnjëherë për rreth 12 vite, duke i krijuar një pozicion tejet të vështirë financiar”.*
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: *“I Të shpallë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme; II Të konstatojë se të drejtat kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut si dhe e drejta për mjete efektive juridike të garantuar me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut të parashtruesit të kërkesës janë shkelur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Aktgjykimit ARJ.nr.102/2021. III. Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin ARJ. nr.102/2021, i Gjykatës Supreme, të dt. 29.12.2021. IV. Të përcaktojë dhe vendosë qfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson si të bazuar në Kushtetutë dhe në Ligj dhe e cila është e arsyeshme për rastin në fjalë”.*

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Nenin 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...].

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, [...]”.

Nenin 13

(E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

35. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

36. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës legjitimohet se është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. nr. 102/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në kërkesën e tij ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajve në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Megjithatë, përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata me tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nënregullin (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39

[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës *KI166/20*, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëgenies Sociale*, Aktvendim për

papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituaniës*, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.
40. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në të vërtetë ka të bëjë me parregullsinë e procesit gjyqësor, e cila ndërlidhet me (i) mënyrën e aplikimit të ligjit material dhe procedural, nga ana e gjykatave të rregullta dhe (ii) me mohimin e të drejtës për qasje në drejtësi.
41. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

i. Përkritazi me pretendimet që ngrenë “çështje fakti dhe ligji”

42. Referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se ai ankohet për shkak se gjykatat e rregullta, duke mos i konsideruar si të kundërligjshme vendimet e autoriteteve të Komunës së Ferizajt; duke mos e zbatuar marrëveshjen për kompensim dhe këmbim të paluajtshmërive, dhe duke i vlerësuar si të ligjshme vendimet për anulimin e marrëveshjes, me arsyetimin se nuk u përfillën procedurat e shpronësimit sipas Ligjit për Shpronësimin e Paluajtshmërive, kanë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se nga gjykatat e rregullta kishte kërkuar të vlerësonin nëse Vendimi nr.01/zyrtarisht i 16 shkurtit 2010 i Kryetarit të komunës B. Xh., për anulimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, dhe Vendimi 01 nr. 159/15 i 26 qershorit 2015, i Kryetarit të komunës M. S., për shfuqizimin e vendimit të mëparshëm 01. nr. 104/2015, të 18 majit 2015, ishin në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.
43. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: *Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua Ligjit NR. 03/L-139 për Shpronësimin, ...neni 21 paragrafi 1, i po këtij ligji parasheh që "Në kuadër të Departamentit të saj për Tatimin në Pronë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të themelojë Zyrën për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme e cila është autoriteti kompetent publik për vlerësimin e të gjitha pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i procedurës së shpronësimit nga cildo Organ Shpronësues. Në rastin konkret gjykata vërejtë se mënyra që është aplikuar me rastin e llogaritjes së kompensimit nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, ngase një formulim i tillë është i paqartë dhe kontradiktorë me vetveten, nuk dihet se sa është çmimi i saktë i kompensimit ngase në marrëveshje është cekur se "kompensimi të bëhet në bazë të fakteve/provave të nxjerra nga Sektori i Pronës, e që sipas llogaritjeve të këtyre provave kompensimi do të behej 1 m2, me 2.40,m2", çka do të thotë se në kohen kur është nënshkruar marrëveshja e cila sipas paditësit ka titull ekzekutiv dhe duhet të*

ekzekutohet, nuk është cekur vlera reale e cila duhet të kompensohet, po ashtu nuk bëhet e ditur formula apo matematika që është aplikuar dhe që ka sjellë deri te ky rezultat i çmimit, e po ashtu nuk ka asnjë provë me të cilën do të dëshmohej se si është llogaritur fitimi i humbur, sa është shuma e llogaritur e fitimit të humbur e cila është dashur të kompensohet por është shënuar vetëm të mënyrë të përgjithshme”.

44. Gjykata vëren se Gjykata Themelore, duke arsyetuar sa më sipër: *“vlerëson se aktvendimi kontestues i të paditurës Komuna e Ferizajt me numër 01.nr.159/15 i datës 26.06.2015 me të cilin është shfuqizuar Vendimi Nr.104/15 i datës 18.05.2015, për ekzekutonin e Marrëveshjes 03-Nr-465-07 i datës 14.01.2010 dhe është i drejtë dhe i bazuar në ligj”.*
45. Tutje, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi: *“Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka gjetur se vendimi i Komunës së Ferizajt, është i ligjshëm i bazuar në Ligj”.*
46. Po ashtu, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili arsyeton: *“... kolegji vlerëson se me të drejtë nga gjykatat e instancave më të ulëta është vërtetuar vendimi i organit të paditur, i cili nuk është përfundimtar sipas mënyrës së vendosjes lidhur me zbatimin e marrëveshjes 03 nr. 465-07, të dt. 14.01.2010, të Lidhur në mes të paditësit dhe palës së paditur dhe nga gjykata e shkallës së parë, organi i paditur është udhëzuar që të veprojnë sipas dispozitave të Ligjit për Shpronësimin nr.03/L-139, lidhur me kompensimin e pronës së shpronësuar”.*
47. Gjykata nga konkluzionet e gjykatave të rregullta vëren se të njëjtat i janë përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për sa i përket pyetjeve nëse vendimet e goditura të autoriteteve të Komunës së Ferizajt, për moszbatimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, ishin nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi. Tutje gjykatat e rregullta arsyetuan faktin se përse në rastin konkret marrëveshja e 14 janarit 2020 nuk ishte bërë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin Paluajtshmërive. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk është pajtuar me konkluzionet e gjykatave të rregullta sa i përket fakteve të vërtetuara dhe ligjit material e procedural të aplikuar.
48. Sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në të vërtetë e ka ndërtuar rastin e tij në baza ligjshmërie dhe jo në baza kushtetutshmërie. Gjykata rikujton se vetëm një pretendim i ngritur në nivel kushtetutshmërie, mund ta vejë në lëvizje atë, për të intervenuar në riparin e shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në rendin juridik të brendshëm (shih, në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese, rasti KI76/21, me parashtrues Qemajl Babuni, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 33).
49. Gjykata rikujton se bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila ndërlidhet me doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht e ka qartësuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të

merret me gabime të fakteve ose të interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për atë sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgijzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).

50. Gjykata vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
51. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih, rastin e GjEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka "aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e "aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar", shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GjEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 36).
52. Nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se efektet e interpretimit dhe të zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale janë jokompatible me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për më tepër, nga konkluzionet e gjykatave të rregullta qartazi mund të vërehet se në dritën e rrethanave të rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me "aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar" dhe as me "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" nga ana e tyre.

53. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me këtë pjesë të kërkesës, i takojnë kategorisë së parë (i) të pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie sepse nuk janë argumentuar në nivel kushtetutshmërie, andaj, të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.

ii. Përkitazi me të drejtën për “qasje në drejtësi”

a) parimet e përgjithshme

54. Gjykata rikujton se e drejta për të pasur “qasje në drejtësi” për qëllime të nenit 6.1 të KEDNj-së është qartësuar në rastin e GjEDNj-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 4451/70 Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36. Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GjEDNj-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në drejtësi” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së (shih, ndër të tjera, përkitazi me të drejtën për qasje në drejtësi, rastin e GjEDNj-së, *Zubac kundër Kroacisë*, nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GjEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime të tij/saj civile” para një gjykate kombëtare të themeluar më ligj (shih, në lidhje me këtë, rastin e GjEDNj-së, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të, si dhe rastin e Gjykatës, *KI143/21*, me parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykimi i 25 nëntorit 2021, paragrafi 50-57).
55. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, përcakton që palët (ndërgjyqësit) duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih, rastet e GjEDNj-së, *Bëleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, nr. 51357/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112, dhe së fundmi rastin e Gjykatës, *KI143/21*, cituar më lart, paragrafi 50).
56. Për më tepër, GjEDNj në rastin e lartcekur, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, (paragrafin 85), thekson se, “kushdo mund të mbështetet në nenin 6.1 të KEDNj-së, kur konsideron se ka një ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e një prej të drejtave të tij ose të saj (civile) dhe ai ose ajo ankohet se nuk ka pasur mundësinë për ta paraqitur kërkesën e tij/saj në gjykatë, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNj-së. Kur ka një mosmarrëveshje serioze dhe të vërtetë për sa i përket ligjshmërisë së një ndërhyrjeje të tillë, neni 6.1 i jep të drejtë individit në fjalë që çështjet e ligjit (ligjshmërisë) të vendosen nga një gjykatë vendore” (shih, rastin e GjEDNj-së, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 29392/95, Aktgjykimi i 10 majit 2001, paragrafi 92; shih gjithashtu rastin *Marković dhe të tjerët kundër Italisë*, [DhM], nr. 1398/03, Aktgjykimi i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 98).
57. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me “të drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GjEDNj-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim

të tillë para një gjykate, mund t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.

58. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, së pari duhet të ekzistojë një e “drejtë civile” dhe së dyti, të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve, duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNJ-së, *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, nr. 6878/75, 7238/75, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, nr. 11296/84, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë* (nr.2), nr. 12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut*, nr. 37575/04, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). “Kontesti”, megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, duhet të jetë: (i) i “vërtetë dhe serioz” (shih, në këtë kontekst, rastet e GjEDNJ-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë “vendimtare” për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, nr. 16742/04, Vendimi i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, “lidhjet e paqëndrueshme” ose “pasoja të largëta” në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GjEDNJ-së, *Lovrić kundër Kroacisë*, nr. 38458/15, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51, dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të, dhe së fundmi rastin e Gjykatës, *KI143/21*, cituar më lart, paragrafi 53).
59. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një “të drejtë civile” dhe një “kontest”, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së i garantojnë individit të drejtën “që çështja të zgjidhet nga një tribunal” (shih rastin e GjEDNJ-së, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih rastin e GjEDNJ-së *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, nr. 5809/08, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).
60. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, Konventa nuk synon të garantojë të drejta që janë “teorike dhe të rreme”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive” rastet e GjEDNJ-së *Kutić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).
61. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih rastet e GjEDNJ-së, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, nr. 61237/00, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, nr. 40786/98, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
62. Parimet e lartpërmendura, megjithatë, nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së.

Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në masën sa të kufizojnë qasjen e individit duke cenuar vetë thelbin e të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNj-së, Baka kundër Hungarisë, nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim” dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GJEDNj-së, Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8225/78, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë, cituar më lart, paragrafi 89; Naït-Liman kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafi 115; Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 17101/03, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe Marković dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99; dhe së fundmi KI143/21, me parashtrues Abdyl Bajgora, Aktgjykimi i 25 nëntorit 2021, paragrafi 57).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

63. Në lidhje me këtë pretendim specifik, parashtruesi i kërkesës thekson se, “Gjykata Supreme ... vetëm ka përshkruar në stilin copy paste Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe në asnjë paragraf nuk i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Madje Gjykata Supreme vjen në përfundim, duke theksuar se parashtruesi i kërkesës duhet që të drejtën e tij ta realizoj në procedurë tjetër të kompensimit sipas Ligjit mbi Shpronësimin, duke mos i trajtuar fare pretendimet e paditësit.
64. Gjykata vëren se thelbi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës për “qasje në drejtësi” ndërlidhet me faktin se Gjykata Supreme, sipas tij nuk i mori parasysh pretendimet e ngritura nëpërmjet mjetit të jashtëzakonshëm, përkritazi me ligjshmërinë e vendimeve të goditura të autoriteteve të komunës së Ferizajt, më të cilat ishte anuluar marrëveshja e 14 janarit 2010, duke pretenduar se në këtë mënyrë i është pamundësuar zgjidhja e kontestit njëkohësisht e realizimit të të drejtave në kuptim të së drejtës për qasje në drejtësi, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.
65. Gjykata rikujton se kur ajo analizon pretendimet për shkelje të së drejtës për “qasje në drejtësi” bazuar në praktikën e GJEDNj-së dhe të saj, merr për bazë përmbushjen dy kushteve themelore: 1) nëse në dritën e rrethanave të rastit kemi të bëjmë me një të “drejtë civile”, dhe 2) nëse kemi të bëjmë me një “kontest” apo “mosmarrëveshje” të vërtetë. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se në rastin para nesh nuk është aspak kontestues fakti se parashtruesi i kërkesës ka hyrë në marrëdhënie juridiko-civile me autoritetet e Komunës së Ferizajt, për shpronësimin e paluajtshmërisë së tij, për të cilin kishte nënshkruar një marrëveshje më 14 janar 2010, me autoritetet e komunës në fjalë, për caktimin e kompensimit dhe të kushteve të shkëmbimit të pronës së tij, me prona në pronësi të kësaj të fundit. Thënë këtë, Gjykata konsideron se në rastin konkret janë përmbushur të dyja kushtet sa i përket çështjes nëse kemi të bëjmë me një të “drejtë civile” dhe “kontest” apo “mosmarrëveshje” të vërtetë, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.
66. Megjithatë, Gjykata në vazhdim dhe në këputim të së drejtës për qasje në drejtësi duhet po ashtu të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës ka marrë një përgjigje meritore dhe të arsyetuar për kontestin e tij nga ana e Gjykatës Supreme, sa i përket mosmarrëveshjes mes tij dhe autoriteteve të Komunës së Ferizajt.

67. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila arsyetoi: “... **meqë në këtë çështje nuk është kontestuese procedura dhe nuk kontestohet vendimi i shpronësimit, por kontestuese në mes të palëve është mënyra dhe lartësia e kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar**, kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se, gjykatat e rregullta në procedurë të konfliktit administrativ, nuk kanë kompetencë ligjore që duke vlerësuar ligjshmërinë e një vendimi administrativ, të vendosin lidhur me ligjshmërinë e vendimit në drejtim të kompensimit, apo të vlerësojnë se është i drejtë apo jo në drejtim të lartësisë apo mënyrës së kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar si në rastin konkret, dhe të obligojnë organin e paditur të bëjë ekzekutimin e vendimit apo marrëveshjes lidhur me kompensim të paluajtshmërisë së shpronësuar”.
68. Tutje, Gjykata Supreme, theksoi: “Kolegji i Gjykatës Supreme ... vlerëson se në këtë çështje nëse organi i paditur nuk ekzekuton marrëveshjen e kompensimit dhe nëse nuk ka dakordim të dyanshëm, lidhur me lartësinë dhe mënyrën e kompensimit, pala e pakënaqur apo pronari i paluajtshmërisë së shpronësuar, si në këtë rast paditësi, në kuptim të nenit 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore nr.03/L-007, mund të fillojë procedura gjyqësore me qëllim të caktimit të kompensimit, me të cilin nën përcaktohet se: “Nëse pjesëmarrësit në procedurën e eksproprijimit (shpronësimit) nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar (shpronësuar), brenda qfatit prej dy muaj nga dita kur aktvendimi për shpronësim ka marrë formën e prerë organi kompetent administrativ ia dërgon aktvendimin e formës së prerë për eksproprijim, bashkë me të gjitha shkresat dhe provat për pagimin e shumës së ofruar të kompensimit pronarit ose për depozitimin e saj, në gjykatë në territorin e së cilës gjendet paluajtshmëria e eksproprijuar, me qëllim të caktimit të kompensimit”, vendimet e instancave me të ulëta janë të drejta dhe të ligjshme”.
69. Sa më sipër, Gjykata vëren pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me vendimet për anulimin e marrëveshjes së 14 janarit 2010, kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga ana e Gjykatës Supreme, duke theksuar se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi dakordim të palëve, nga shkaku se Komuna e Ferizajt, përfundimisht nuk është pajtuar me mënyrën e përcaktimit të kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës është udhëzuar që çështjet e kompensimit përkitazi me paluajtshmërinë e shpronësuar, si dhe humbjet e pësuar nga mosshfrytëzimi i saj, mund t'i realizojë në gjykatën civile në procedurë jokontestimore, meqë vendimi për shpronësimin nuk është kontestuar.
70. Andaj, Gjykata në kuptim të mbrojtjes e të drejtave kushtetuese, respektivisht në kuptim të drejtës për qasje në drejtësi, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur në asnjë mënyrë të dëshmojë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.
71. Nga arsyet e lartcekura, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me shkeljen e të drejtës për “qasjes në drejtësi” i takojnë kategorisë së (iii) tretë, të pretendimeve të “pambështetura ose paarsyetuara”, andaj të njëjtat në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara.

Përfundime

72. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, kolaudon se:

- i. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të procesit të rregullt ligjor në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave të rregullta, ngrenë “çështje fakti dhe ligji” dhe si të tilla i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve të “shkallës së katërt”, sepse reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe jo kushtetutshmërie, prandaj të njëjtat shpallen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese;
- ii. pretendimet për shkelje të së drejtës për “qasje në drejtësi”, i përkasin kategorisë së (iii) tretë, të pretendimeve të “pambështetura ose paarsyetuara”, andaj edhe këto duhet shpallur qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
73. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 8 shkurt 2023, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani